


# DEMOSGAZETA



# PARIMET E DEMOKRACISË

ERIOLA (9), REA (9), JUSTINA (9), LIZA (9), DRENIT (9), SHEND (9), ALBANI (9), DIONI (9)

## Informacionet tona për demokracinë

Qeverisja e popullit quhet demokraci, e aty njerëzit me dëshirën e tyre zgjedhin njerëzit që do ta përfaqësojnë popullin. Elementet kyçe të demokracisë janë: të folurit lirshëm, barazia, respekti, toleranca dhe liria. Forma e parë e demokracisë u paraqit në Athinë, në kryeqytetin e Greqisë.

Ne në Kosovë kemi demokraci përfaqësuese, që do të thotë se ne i zgjedhim vetë përfaqësuesit e popullit tonë. Demokracinë e bën vetë populli, duke i ndjekur parimet e saj që kanë shumë vlerë.


Edhe ne si qytetarë të Republikës së Kosovës, duhet t'i ndjekim këto parime demokratike në mënyrë që të jemi qytetarë sa më të mirë dhe sa më të përgjegjshëm.



Gazetarët e demokracisë




Elementet e demokracisë e rregullojnë jetën tonë



Ne jemi të barabartë



Simboli i paqes



Parimet e demokracisë: liria, barazia, respekti, toleranca

# KUVENDI DHE DEPUTETËT E RINJË

BARDHI (9), DAJTI (9), ENESI (9), ERINA (9), ELEMEDINA (9), NORIKU (9), OLTA (9)

*Kandidatët për deputetë dhe shpalosur planprogramin e tyre për deputetë*



## Kuvendi i Kosovës është organi më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës, i cili zgjedhet drejtpërdrejt nga populli

Ne sot mësuam për Kuvendin dhe për deputetët. Ne do t'iu tregojmë se si funksionon Kuvendi dhe si zgjedhen deputetët e cilat janë detyrat e tyre si deputetë të Kuvendit.

Kuvendi i Kosovës është institucioni më demokratik, sepse përfaqësuesit e tij janë zgjedhur direkt nga populli. Këta përfaqësues ne i quajmë deputetë, të cilët kanë detyra dhe përgjegjësi, që duhet t'i zbatojnë patjetër. Këto detyra dhe përgjegjësi janë të rregulluara nga Kushtetuta e Kosovës.

Në Kuvend janë gjithsej 120 deputetë, ku 100 zgjedhen nga populli, ndërsa 20 vende janë të garantuara për komunitetet jo shumicë, që do të thotë se edhe këto komunitete i zgjedhin përfaqësuesit e tyre.

Në mënyrë që të gjithë këta deputetë të kuptohen në

mes vete, përpos në gjuhën shqipe, temat që ata i diskutojnë në seancat që i mbajnë përkthehen në tri gjuhë të tjera: në gjuhën serbe, në gjuhën turke dhe në gjuhën angleze.

Kuvendi i Kosovës, përveç tri funksioneve kryesore si p.sh. funksioni legjislativ, gjithashtu mbikëqyr Qeverinë, si dhe përfaqëson popullin e Kosovës, por po ashtu edhe miraton buxhetin e Kosovës që e propozon Qeveria. Fjala deputet e ka kuptimin e fjalës përfaqësues, e që ne me këtë kuptojmë që deputetët e përfaqësojnë popullin i cili i ka votuar ata. Edhe pse deputetët i përkasin partieve të ndryshme politike, Kushtetuta e parasheh që ata zgjedhen nga populli dhe e përfaqësojnë popullin. Të drejtën për të kandiduar për deputetë e kanë të gjithë qytetarët që janë mbi moshën 18 vjeçare. Të gjitha këto që i cekëm më lart, ne sot i mësuam rreth Kuvendit të Kosovës dhe deputetëve, si dhe çfarë detyrash kanë si deputetët ashtu edhe Kuvendi. Kuvendi është „Shtëpia e Popullit“.



Disa funksione të Kuvendit



Puna jonë në grup

# NE FLASIM PËR ZGJEDHJET


DION (9), ALTINI (9), ERZA (9), MERIS (9), RIGA (9), LINEA (8), KANINA (9)

Artikulli ynë flet për demokracinë dhe për zgjedhjet e lira dhe demokratike



Grupi i gazetarëve

Demokracia e ka kuptimin e udhëheqjes së popullit. Në zgjedhjet demokratike marrin pjesë qytetarët, të cilët zgjedhin përfaqësuesit e tyre. Deputetët të cilët zgjedhen nga populli duhet të punojnë për qytetarët. Ne duhet të shkojmë për të votuar nga mosha 18 vjeçare. Në zgjedhje marrin pjesë gratë dhe burrat dhe komunitetet e tjera jo shumicë si komuniteti serb, turk, boshnjak, etj. Kandidatët garojnë për 120 ulëset e Kuvendit. Përfaqësuesit quhen deputetë dhe ata punojnë në Kuvend. Deputetët votojnë ligjet. Ligjet janë rregulla, të cilat të gjithë ne duhet t'i zbatojmë. Pastaj, Qeveria i zbaton ato ligje. Ne mendojmë se është e rëndësishme të votojmë, sepse ata deputetë na përfaqësojnë neve, dëshirat dhe mendimet tona.



Punimi për zgjedhjet



Vota për Kuvendin



Grupi duke punuar



Këtu kemi shpjeguar demokracinë dhe zgjedhjet

# NDARJA E PUSHTETIT NË DEMOKRACI

OLTI (9), ADRIAN (10), OMER (9), JORA (9), ERINA (10), RONA (10), YLJAN (9)

## Si funksionon ndarja e pushtetit në demokracinë përfaqësuese parlamentare?

Në një shtet demokratik qeveris populli. Në këtë mënyrë, qytetarët votojnë përfaqësuesit e popullit. Këta përfaqësues quhen deputetë.

Tri pushtetet në demokraci janë: Kuvendi, Qeveria, gjykatat. Demokracia e lashtë ka origjinë greke. Kurse, më vonë është përhapur në Evropë.

Kuvendi është vendi ku miratohen ligjet, Qeveria është vendi ku ekzekutohen ligjet, ndërsa gjykata është vendi ku vendoset drejtësia. Kur kalojmë në semaforin e kuq, atëherë ne i thejmë rregullat e komunikacionit. Me drejtësinë e vendit nëse respektohen rregullat apo ligjet e vendit merret gjykata e atij vendi.



Autorët e artikullit

Sot do të vendoset se a do të miratohet një ligj apo jo



Deputetët duke diskutuar


Ne duhet të respektojmë rregullat



Gjykatësit duke biseduar



Ministri duke propozuar një ligj



Ne duhet të respektojmë rregullat



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Faik Konica“  
Klasa: IV-4  
Vendi: Prishtinë